

THE SHAKESPEARE, MERIMEE AND KADARE FAMILY NAME AND HONOUR NDERI I EMRIT DHE I FAMILJES TE SHEKSPIRI, MERIME DHE KADARE

VALBONA GASHI-BERISHA
Prishtinë
Email: Valbonagashi@uni-pr.edu

AKTET VI, 3: 265-269, 2013

PËRMBLEDHJE

Trekëndëshi i tre autorëve më të njohur të letërsisë europiane na paraqet personazhe që thellë në shpirtin e tyre është rrënjësor nderi i emrit të familjes me vlerën më të lartë njerëzore. Personazhet si Hamleti i Shekspirit, Mateo Falkone i Merimes dhe Gjorgji i Kadares kanë të përbashkët ndjenjën e nderit që duan ta ruajnë me çdo kusht çoftë edhe me jetë. Në fakt, këto personazhe i japin një çmim nderit të emrit, të familjes. Prej momentit që nderi preket, gjithçka ndryshon për këta heronjë-viktima. Lufta në mes njeriut dhe fatit të tij është një dilemë që shfaq agjitacion të brendshëm te heronjtë tanë. Dilema e brendshme e tyre kthehet në një vendim marrje që nuk ka kthim mbrapa. Gjendja e tyre shpirtërore u mundëson atyre të kryejnë edhe aktet më mizore vetëm e vetëm të ruajnë nderin e emrit dhe të familjes.

Fjalë kyçe: Nderi, Emri, Familja, Vlera, Dilema

SUMMARY

A triangle of three most famous authors of the European literature presents to us characters that deeply in their soul is rooted family name with the highest human value. Characters as Hamlet by Shakespeare, Mateo Falcone by Mérimée and the George by Kadare have in common a sense of honour who wants to keep by all the means either with a life. In fact, these characters give an award to honour the family's name. From the moment when honour is touched, everything changes for these heroes and victims. The war between man and his destiny manifest a dilemma which shows internal agitation of our heroes. At the beginning these heroes hesitate, the dilemma follows them everywhere and in every corner of their mind. Their spiritual statue enables them to perform even the most atrocious acts solely to keep honour and family name.

Key words: Honour, Name, Family, Values, Dilemmas

Tema e tragjedisë së Shekspirit është hakmarrja: Hamleti duhet të hakmirret kundër axhës së vet Klaudius i cili ka vlarë mbretin Hamlet. Klaudius do të kishte vlarë të vëllain për t'ia marrë fronin mbretëror dhe gruan: në fakt, pak pas vdekjes së mbretit, Klaudius bëhet mbret dhe martohet menjëherë me Gertruden, nënën e Hamletit dhe bashkëshorten e mbretit.

Personazhi i Hamletit është personazh dramatik, që secilin lexues e bën të mendoj jo vetëm për sjelljet e veta (dyshimet e tij dhe mënyra se si do ta bëj komplotin), por gjithashtu edhe për

vetmin. Edhe pse kishte disa shokë dhe të fejuarën, të famshmen Ofeli, Hamleti duket se është i vetëm. Sikur vdekja e babait t'i kishte caktuar një kufi të padukshëm në mes tij dhe të tjerëve; sikur Hamleti të ishte i obliguar të jetonte larg të tjerëve, jo aq fizikisht sa psikikisht. Ndjehet i humbur. Hamleti torturohet kur fillon të mendoj për gjakmarrje, për fatin e tij, një mallkim për këtë princ që destabilizon edhe njerëzit që e rrethojnë.

Enigma e personazhit si e Hamletit gjindet në një labirint. Shumë kritikë letrar kanë analizuar

psikologjinë e tij si njeri që është i lidhur me fatin e njerëzve që e rrethojnë. Para se të paraqitet Fantazma, Hamleti është në një gjendje pa ekzistencë. Mbanë zi dhe kalon ditët pa jetuar. Bëhet i gjallë vetëm pas paraqitjes së Fantazmat, dhe për ti dhënë këtë lindje të dytë, Hamleti baba vesh rrobat që i kishte veshur kur ka lindur Princi. Ky i fundit gjen arsyen për të jetuar dhe e ballafaqon problemin e vdekjes: atë të babait, të veten dhe atë të axhës. Do të duhet që Princi të kalojë në ekzil, të luftoj kundër piratëve, të meditojë te varreza.

Edhe Gjorgji te Prilli i thyer ka një pasiguri në vetvete dhe në këtë pikë i ngjan së tepërmi Hamletit. Kontradiktat që i kanë këto personazhe reflektojnë idet dhe ndjenat e tyre e sidomos një reflektim i thellë kur është rasti te monologu: "To be or not to be", monolog që reflekton dimensionin tragjik të personazhit. Ky është një monolog që nuk është përqëndruar vetëm te Hamleti, por mbi të gjitha është universal.

Dukja e Hamletit dhe Gjorgjit jep një pasqyrë të dëshirës dhe mendimit të fshehur që në vend se këto personazhe të shprehin lirishëm, përdorin gjuhën e simboleve që shprehin edhe dhimbjen edhe kontradiktat.

Çmenduria e tij nuk lidhet shumë me vdekjen e babait, sepse Hamleti e kupton vrasjen në skenën e pestë të aktit të parë, kur paraqitet fantazma, derisa çmenduria e tij duket shumë më herët, qysh në skenën e dytë.

Në fakt është një spektër, i cili ia tregon të vërtetën se vdekja e babait të tij nuk ka ndodhur për shkak të një kafshimi të gjarpërit, por është vëllai i tij Klaudius i cili e ka vrarë duke i hedhur helm në vesh, kur ai flinte si zakonisht në kopsht gjatë një pasdite.

Për të besuar në këtë qështje, po bazohemi në realitetin e një fantazma, i cili i thotë të vërtetën Hamletit. Po si ndodh që Gertruda nuk e sheh e as nuk e ndëgjon këtë spektër? Hamleti është i vetmi që komunikon me fantazman. Asnjë personazh tjetër nuk arrin të komunikoj me të. Nëse vetëm Hamleti komunikon me fantazman, mund të themi se ai komunikon me vetveten: Hamleti ndëgjon zëra, në këtë kuptim dhe vetëm

në këtë kuptim, që fantazma është real. Hamleti e quan fantazman ende pa e parë si shpirti e babait (father's spirit), pastaj edhe vet fantazma prezentohet: unë jam shpirti e babait tënd (I am thy father's spirit).

Nëse Hamleti flet me vetveten duke biseduar me fantazman, mund të supozojmë se fantazma nuk i tregon asgjë të re. Tërë atë që i thotë fantazma, Hamleti e din më parë: nëse pra është e vërtetë se babai i tij është vrarë, ashtu siq thotë fantazma, Hamleti e din këtë dhe me këtë mund të supozojmë se çmenduria e tij është e lidhur me vrasjen. Më lartë thamë se fantazma është prezentuar si shpirti i babait të tij, duke cekur edhe një element të rëndësishëm kur ai thotë se i ka spastruar me zjarr gabimet e këqija, (the foul crimes) që i ka bërë kur ishte i gjallë. Këtu kemi të bëjmë me një mospërputhje të ideve pasi që fantazma thotë se është vrarë nga i vëllai, i cili ia kishte futur një helm në vesh kur po flinte. Kjo nuk ka asnjë kuptim: nëse flinte, si është e mundur të dij se kush ishte ai i cili e vrau, si mund ta dij mënyrën se si e vrau? Pastaj pak më vonë, Hamleti gjatë dialogut e thotë një fjalë të çuditshme: ai e donte aq shumë nënën time (so loving to my mother). Shprehet kështu sikur të kishte një kundëthënje. Fakti se babai i tij po digjej në zjarr për gabimet e bëra dhe fakti se e dashuronte gruan, janë në kundërshtim njëra me tjetrën. Çfarë gabime kishte bërë? Se ishte me një femër tjetër?

Hamleti kthehet pa paralajmërim nga Wittenberg dhe e gjen babain e tij në shtrat pranë të dashurës së tij, Ofelis. Të dy flenin dhe në atë çast vëren veshin e madh të babait që flinte në krah dhe i çmendur nga kjo pamje e mbyt babain duke ia hedhur një helm në vesh. Tani mund të kuptojmë më mirë pse çmenduria e Hamletit koncidon me vdekjen e babait dhe arsyen e mbajtjes zi për një kohë të gjatë për shkak më shumë të gabimit të babait, se sa zija për vdekjen e tij. Kjo është edhe pasoja që babai e çnderoj të birin dhe ai tani më është në zi dhe në gjendje të rëndë shpirtërore.

Ofelia pastaj zgjohet me një kufomë: të jeshë apo të mos jeshë, të flesh, të vdesish. Në situatë të

tillë, ajo është e obliguar të heshtë. Ajo e qon kufomën në kopshtin e tij dhe lajmëron se ka vdekur nga një gjarpër. Ajo nuk e din se mbreti është vrasëri, mendon se ka vdekur nga ndonjë sulm zemre apo ndonjë sulm tjetër, pasi që ai ishte i thyer në moshë. Ja se çfarë Hamleti don ti tregoj Ofelis, se ka pasur një dëshmitar të kësaj skene, dhe vendos që t'ia bëjë të ditur pa shprehur asnjë fjalë: mënyra e komunikimit me të është qetësia, dhe fjala qetësi është fjala e fundit që ai e thotë para se të vdes: ajo që mbetet është qetësia (the rest is silence).

Nëpërmes qetësisë, Hamleti provon të komunikoj tri herë me Ofelin dhe vetëm me herën e tretë e realizon. Në tentativën e parë, Hamleti shkon ta shoh pa i thënë asgjë : Ofelia nuk kupton asgjë. Babai i saj Polonius mendon se është shikim dashurie. Tentativa e dytë është biseda e tij me Ofelin: në fillim thotë: të jeshë apo të mos jeshë (to be or not to be), pastaj të vdesësh, të flehsh (to die, to sleep). Në mungesë të didaskalisë, nuk e dijme nëse Ofelia i ka ndëgjuar këto fjalë apo jo. Pastaj, kur filluan bisedën, Hamleti i tha pesë herë të shkoj në një manastir (get thee to a nunnery), me formulime të ndryshme, por që janë të njëjta. Fjala manastir ka dy kuptime: njëri është manastir ku shkohet si lloj izolomi deri në fund të jetës, dhe tjetri është shtëpi e mbyllur, që Polonius e quan shtëpi të shitjes, d.m.th. shtëpi publike (a house of sale videlicet a brothel) ku ka prostituta: me sa duket Hamleti e trajton Ofelin si prostitutë pas asaj çfarë ka parë. Ai e pyet Ofelin nëse ajo është e ndershme (are you honest?), duke e ditur shumë mirë se jo. Nocioni i nderit është për Hamletin nocion i familjes që ruhet me gjenerata.

Dhe tentativa e tretë, që funksionoi, është pantomima. Të gjithë mendojnë se Klaudius është vrasëri dhe pantomima i drejtohet atij, mirëpo kjo pantomimë i drejtohet Ofelis që, këtë herë, e kupton mesazhin e Hamletit, i cili e kishte organizuar pjesën teatrale. Tani Ofelia humb torruan dhe shqetësohet se ç'do të thotë kjo mimikë, e pyet Hamletin për domethënjen e saj (what means this, my lord?) dhe tani e kupton se mbreti nuk kishte vdekur ndryshe, por e kishin

vrarë. E nëse është vrasëri, ka një dëshmitar, e ky duhet të jetë vet vrasësi : tani e kupton më çartë se Hamleti e ka parë skenën dhe, për këtë arsye, e ka vrasëri babain e vet. Gjithçka ka marrë fund për të, dhe vjen në përfundim se sa më shpejt ajo duhet të vetvritet, pasi që nuk mund asnjëherë ta shikoj më në sy e mos të flas për martesë.

Tani e kuptojmë se ka gjëra të kalburës në mbretërinë e Danimarkës (something is rotten in the state of Denmark). Ngjarja sa vjen e bëhet më e komplikuar: Hamleti mbyllet rastësisht babain e Ofelis, Poloniusin. Ajo kërkon audiencë në oborrin mbretëror jo për të qarë të atin, por për të shprehur lamtumirën e saj të fundit dhe atë sa më shpejt. Më vonë e mësojmë se ajo është mbytur në ujë. Kjo është mënyra se si Hamleti desh i ta varroste nderin e babait të tij dhe të Ofelis e, mbi të gjitha, nderin e tij. Ai vet do të vdes së bashku me këtë sekret, duke lënë vetëm një të gjallë, Horatio, si dëshmitar i kësaj ngjarje që kishte vetëm disa grimca të së vërtetës, të cilat kurrë nuk do të tregonin se çfarë ka ndodhur në Elsenaur.

Hamleti nuk e mbyllet Klaudius kur mundet, sepse ai e din shumë mirë se nuk është ai i cili e ka vrasëri babain e tij. Nëse e luan rolin se duhet të marrë gjakun e babait, ishte sepse ai dëshironte të largohej sa më shumë nga e vërteta.

Klaudius nuk i beson versionit se vëllau i tij ka vdekur nga gjarpëri. Ai e din shumë mirë se dikush e ka vrasëri por nuk e din se kush, si dhe pse. Një veprim i Hamletit që përfundon pa lënë gjurmët e së vërtetës është fjala e tij te varri i Ofelis: e doja Ofelin (I loved Ophelia), që ishte më se e vërtetë.

Fakti se Hamleti e mbyllet Klaudius në pjesën e fundit, pasi mbante shpatën e helmuar, të jep përshtypje se përfundon me marrjen e gjakut. Ai hakmirret kundër Klaudiusit, sepse e din se ai ka organizuar ekzilin e tij që e qonte në vdekje, dhe se e kishte mashtruar duelin e tij me Laertes. Në fakt, Hamleti hakmirret për të gjitha këto raste e jo për vdekjen e babait të tij. Bëhet fjalë për hakmarrje e jo gjakmarrje dhe kjo është realizuar qysh në fillim të tragjedisë.

Mund të thuhet se, në çdo vend dhe në çdo kohë, jeta dhe nderi i një femre është jeta dhe nderi i një burri dhe se të gjitha ofendimet që kanë të bëjnë me nderin e një femre janë ato të cilat shkaktojnë më së shumti armiqësi. Sipas Kanunit “ndera e marrun gjobë nuk ka, ndera e marrun s’falet kurrë”, e njejtja aksiomë është edhe te korsikanët “gjaku i derdhur ndreq nderin e humbur”. Kur nderi preket, secili antar i familjes është i gatshëm të sakrifkohet siq e thotë edhe proverba latine “Homem honrado, antes morto que injuriado” (Njeriu i nderit, më mirë i vdekur se sa i poshtuar).

Mund të themi se në Prillin e thyer, vdekja i jep një lloj fisnikëri jetës. Mjafton një derdhje gjaku që vrasësi të futet në një sistem të mbyllur. Kështu « ...në shtëpitë ku kishte hyrë gjaku, kishte një tjetër rrjedh ditësh dhe stinësh, një si dridhje të brendshme dhe njerëzit dukeshin si më të bukur ...”.

Gjorgji është njeriu i vetëm i cili e paramendon vdekjen e Zef Kryeqyqes, e cila është e lidhur me vdekjen e tij dhe se varrimi është gjithashtu i tij. Është hero i gjakmarrjes dhe roli i tij është të pranoj fatin, duke iu afruar vdekjes pa asnjë dridhje. Në këtë gjendje shpirtërore ai shprehet: «Dy gishta nderi mbi ball... Ai prekte ballin me dorë, si për të gjetur përkitas vendin ku mund të ishte nderi”, “Nderi e ka vendin e vet në mes të ballit sepse ky ishte vendi ku plumbi duhej ta prekte kokën e tjetrit”.

Ekzistenca e tij si hero nuk do të zgjaste shumë. Ai duhej të përfitonte sa më shumë në fatin që iu kishte rezervuar që para lindjes në këtë zonë “ku rregullat e vdekjes sundojnë mbi ato të jetës”.

Metonimia e “ballit” paraqet imazhin par excellence të universit të nderit. Për Kadaren, balli ka gjithashtu rolin e krenarisë. Prej momentit kur Gjorgji e ka marrë gjakun e vëllaut, ai tani është vrasës dhe, sipas Kanunit, duhet të respektoj rregullat për familjen e viktimës. Gjakmarrja vjen si rezultat i ruajtjes së nderit të familjes, që është detyra kryesore e imponuar nga ligji i natyrës. Çështja më e rëndësishme për Gjorgjin, personazhin e Prillit të thyer, është jo vetëm të marrë gjakun e humbur dhe t’ia kthej

nderin familjes, por edhe të tregoj për burrërin e tij. Sipas rregullave të Kanunit, Gjorgji i jipet besa e madhe prej 30 ditësh. Kjo besë ju ka dhënë atij më 17 mars, dhe ka lirin për 30 ditë, pra 30 ditë ai nuk e rrezikon jetën e tij. Sipas tij janë 30 ditë: gjysmë mars “gjysmë e ngrir” dhe gjysmë prill “prill i vdekur”, “prilli i thyer”. Jeta e tij është ndar në dy dimensione: “E gjatë, 26 vjet dhe e shkurtë, katër javë”.

Fati i Gjorgji është shënuar në gurët e kullës së Oroshit dhe pikërisht në këtë kullë ai duhet të paguaj tatimin që e ka marrë gjakun e pastaj ai mund të pres në mënyrë të ndershme vdekjen. Nëse “tragjedia greke tregon sidomos pafuqin e njeriut para asaj që është e shkruar në qiell”, në romanin Prilli i thyer, njeriu është i pafuqishëm përball Kanunit. “Ky Kanun, i cili i nxit njerëzit të marrin gjakun në emër të nderit, e përgjon edhe gjestin më të vogël të personit që duhet të marrë gjakun”. Në këtë aspekt, Kanuni është më i ashpër sesa Erinit e Eskilit. “Erinit nuk i ndiqnin të gjithë vrasësit, sikurse është rasti te Kanuni, mirëpo vetëm ata të cilët kanë bërë që të derdhet gjaku i vet (familjes se qumshtit). Ato akuzojnë djalin që e vret nënën, por jo gruan që vret burrin”.

Tërë procesi i gjakmarrjes ndodh gjatë ditës dhe para syve të lexuesit, mënyrë kjo që të shihet më mirë fuqia e tmerrit të gjakut. “Për Gjorgjin gjithëçka është përcaktuar më herët, ora e vdekjes është një moment që e pret. Ai e gjen vdekjen në mbarim të ditës në mënyrë që gjakmarrja të mund të rifilloj qysh të nesërmen”. Në Prillin e thyer, Kadare ka dashur të tregoj fenomenin tragjik të gjakmarrjes, një univers i Atridëve në ditët e sotme. Ai e gjen mënyrën letrare të inspirimit tek Eskili mirëpo, realiteti i jetës së përditshme ishte një bashkdyzim që dha romanin me ndjenja nga më tragjike. Këtë më së miri e afirmon E. Faye, i cili thotë se Kadare « ka vendosur në Prillin e thyer ndjenjën tragjike dhe frymëmarrjen që ngjall Orestin ».

Universi tjetër është ai i Merimes, i cili si etnolog interesohet shumë për zakonet e Korsikës. Gazeta e asaj kohe, Le Globe publikon, prej 25 maj 1826 deri 6 mars 1827, gjashtë artikuj mbi

nderin dhe mikpritjen korsikane. Vlen të ceket Julian Pitt-Rivers i cili në *Anthropologie de l'honneur* e ka paraqitur mjaft mirë qështjen e nderit në vendet mesdheut. Duke u bazuar në këto studime, nderi dhe mikpritja janë shumë të ngjashëme në mes shqiptarëve, korsikanëve dhe vendeve të mesdheut. Në tregimin Mateo Falcone, Merime flet për një shkelje të mikpritjes së një fëmiu dhe vrasjen e tij nga babai, pasi që nuk e kishte ruajtur nderin e emrit dhe të familjes. Nderi i Mateos është nderi i emrit, nderi i familjes, nderi i klanit e gjithashtu edhe nderi i gjithë Korsikës. Fortunato, djali i vetëm i Mateos, bën një gabim thelbësor: pranon orën prej ari që ia ofron Gamba dhe e denoncon banditin Gianetto, i cili e pështyn te praku dhe e quanë: "shtëpi tradhtari!".

Fortunato, para se ta tradhëtoj Gianetton, i përgjigjet Gambës, i cili don ta kontrolloj shtëpinë: "Çfarë do të thotë babai (...) nëse e din se keni hyr në shtëpi kur ai ka dal". Fortunato e cek karakterin e shejtë të shtëpisë prindërore. Banditi Gianeto Sanpiero jeton në një kasolle dhe ka probleme me qeverinë. Një ditë gjandarmëria e përndjek dhe duke ikur ai mbërrin te shtëpia e Mateo Falcone, i vetmi vend për tu fshehur. Gianeto është korsikan dhe i din mjaft mirë rregullat e mikpritjes dhe të mbrojtjes, kështu që e din se do të mbrohet, sidomos kur e thotë emrin e babait të Fortunatos: "Ti je djali i Mateo Falcone". Banditi e din se ligjet e mikpritjes duhet ta mbrojnë. Ai bazohet në këtë dhe i drejtohet Fortunatos duke i thënë: "Ti nuk je djali i Mateo Falcone! Ti do të më lesh të më arrestojnë para shtëpisë tënde?"

Fortunato pasi e tradhëtoi Gianeton i jep "një gotë me qumsht" f. 15, por është tepër vonë: Gianeto e refuzon dhe kthehet nga njeri prej atyre që e kanë arrestuar dhe i kërkon ujë. Ai e pranon ujin nga një njeri që sapo ka luftuar. Ai preferon një armik të ndershem se sa djalin e një shoku që e tradhton familjen. Gabimi thelbësor i Fortunatos është vetëm fillimi i tmerrshëm që do ta qoj drejt vdekjes. Mateo i fal të gjitha, ai e ka fal Gianeton kur i ka vjedh një dhi, por nuk mund

të fal djalin e tij që ia ka humbur nderin e emrit dhe të familjes. Fortunato është trashëgimtar i familjes dhe nderi i emrit që mbante duhet të ishte simbol i jetës së tij. Padyshim, vlera e vetme e cila paraqetet në këtë tregim është nderi.

Shekspiri, Merime dhe Kadare përshkruan vlerat njerëzore, ku dinjiteti dhe nderi i emrit janë mbi të gjitha dhe, në rast se ato shkenen, atëherë dënimi nuk mund të evitohet. Gjaku dhe nderi janë dy simbole të rëndësishme në jetën e njeriut që secila shoqëri dhe secili njeri duhet t'i ketë parasysh dhe t'i vlerësoj ato si gjënë më sublime. Në shkrimet e Shekspirin, Merimes dhe Kadares gjinden të gjitha, të gjitha ndjenjat njerëzore, prej atyre më fisniket deri te ato më të ulëtat: nderi, fisnikëria, guximi, shoqëria, gjelozia, komploti, incesti, vrasja, gjakmarrja. Tabloja e tyre është një lloj përmbledhje e shoqërisë, që ilustron mënyrën se si qenja njerëzore reagon kur gjindet përball një situatë dramatike.

Literature

1. FAYE, Éric, Ismail Kadaré, Prométhée portefeuille, Paris, José Corti, 1991
2. GASHI, Valbona, Perspectives comparatistes à partir de l'œuvre de S. Frasher, étude du thème de la bessa et de la vendetta... A.N.R.T., Lille, 2000
3. GJEÇOVI Shtjefën, Kanuni i Lekë Dukagjinit, Tiranë, Albinform, 1993
4. KADARE, Ismail, Prilli i thyer, Onufri, Tiranë 2003
5. KOSKO, Marja, Le thème de Mateo Falcone, Nizet, 1960
6. MERIMEE, Prosper, Mateo Falcone, Booking International, Paris, 1993
7. PITT-RIVERS, Julian, Anthropologie de l'honneur, Hachette, Paris, 1997
8. SHAKESPEARE, Hamlet, edited by Bernard Lott M.A, Ph.D, Longman Group Limited, 1968
9. SHAKESPEARE, Hamlet, Othello, Macbeth, traduction de F. V. Hugo, collection «le livre de poche», édition librairie générale française, Paris, 1984.